



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr.45, datë 23.09.2015

Për

**“DHËNIEN E PËLQIMIT PËR VENDOSJEN E MONUMENTIT TË MIQËSISË MIDIS
POPUJVE TË KUVAJTIT DHE TË SHQIPËRISË NË LULISHTEN MIDIS RRUGËVE
“LUDOVIK SHLLAKU” DHE “28 NËNTORI””.**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/VII, shkronja “a”, nenit 10, pikat 3/I, shkronja “ë” dhe pika 3/II, shkronja “a”, nenit 32, shkronja “m” dhe nenit 33, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. “Dhënien e pëlqimit për vendosjen e monumentit të miqësisë midis popujve të Kuvajtit dhe të Shqipërisë në lulishten midis rrugëve “Ludovik Shllaku” dhe “28 Nëntori””, sipas planvendosjes bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Investimeve të Huaja, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

ALDRIN DALIPI